


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-32  
066



# VAJZAT DHE USHTARI

MINA T. QIRICI

834-32

R 66.

MINA T. QIRICI

# VAJZAT DHE USHTARI

*Tregime dhe skica*



SHTËPIA BOTUËSE  
«NAIM FRASHERI»

## DEMO ÇOBANI

Demua ishte nisur për në repartin ushtarak. I gëzohej zemra, kur shkonte në stërvitje, kur përkë-dhelte pushkën, kur rrinte branë topit, kur mbante predhën në dorë, sepse i kujtonte atë, kohën e luftës, jetën partizane, kur luftonte me një top gjerman, që ua kishin kapur nazistëve.

Mbas luftës ai përsëri ishte kthyer në fshat dhe ishte marrë me zanatin e tij, me zanatin e çobanit, sepse «edhe këtë punë dikush do ta bënte», thoshte Demua. Por tani këtë punë e bënte me dëshirë, sepse nuk ruante bagëtinë e heut, por të bashkëfshatarëve të tij dhe më vonë të kooperativës.

Kur e thirrën Demon, në stërvitje ushtarake, ai u tha se kishte dëshirë të shërbente në artileri. Kiske qenë «artilier» dhe nuk mund ta ndryshonte «professionin».

— Në kohën e luftës kam qenë gradues, ndaj dhe këtu këtë detyrë dua të kryej — i kishte thënë ai komandantit.

Komandanti kishte buzëqeshur duke i rrahur krahët.

Kur bënин qitjet dhe bëredha shpërthente me zhurmë në objektiv, duke ligritur shtëllunga të mëdha tymi, ai fërkonte mustaqjet e ngrinte gjoksin lart

për të parë nga numrorët si të donte t'u thoshte:  
— E shikoni se çfarë bën graduesi?

\* \* \*

Topi i parë kishtë mbetur pa shenjues, ndaj ai u ngrit dhe iu afrua shenjestrës. Por para saj ishte krejt i pazoti dhe nuk dinte asgjë. Ai dinte vetëm detyrën e graduesit. I vinte turp të pyeste komandantin, se pastaj shokët do të qeshnin e do t'i thoshin:

— «E, o xha Adem, ti kë qenë dhe artilier i vjetër, që nga koha e luftës partizane!»

«Hajde jepi dum kësaj shenjestre, këtij topi, që ne në atë kohë as në ëndërr nuk e shikonim. E ç'më bëri Aliu, që s'erdhi. Si t'ia them komandantit që s'ka kush e rregullon këtë dreq shenjestre? E, Demo, Demo, u turpërove sot. Po pse xhanëm, nuk i hapje sytë të shihje Aliun kur e rregullonte? — thoshte me vete xha Ademi që përsëri nuk donte të jepej. Filloi të lëvizte burmat, rrëthim e drejtimit, po s'po i ecte, si atëhere në luftë.

2

...Atëhere Demos i kishin vënë nofkën «Cobani». Me këtë nofkë ia thërrisin edhe të atin, Nesimin, sepse me këtë punë ishte marrë dhe i ati. Madje i ati ia mësoi dhe Demos. E merrte gjithmonë me vete dhe e mësonte se ku të kulloste bagëtinë, ku të pinte ujë e ku të pushonte. «Se bagëtija, more bir, nuk ka gojë, por shpirtin e ka si të njeriut, paçka se janë të bent këto kafshë të uruara.»

4

— Kaq dinte plaku, kaq thoshte dhe Demua e dëgjonte me vëmendje.

Një ditë plaku vdiq. Demua ishte atëhere vetëm 17 vjeç dhe mbi shpatullat e tij të njoma ranë të gjitha hallet e shtëpisë. Beu i paguante pak, fare pak, sa për të mos thënë asgjë.

— Hajde, derr, dhe këto shumë i ke — i hakë-rrohej, kur çobani shkonte për t'i kërkuar rrrogën e muajit. — Ushqehesh me qumshtin tim, edepzës!

— Jo, efendi, nuk vë asnjë pikë në gojë. Qehajallarët e masin me gram — i përgjegjej djaloshi Demo, e përbrenda i vlonët urrejtja që i zhurmonte si një vullkan në shpërthim.

Kështu i kalonin ditët Demos. Erdhi një kohë dhe Demua u martua. Donte një nuse nëna plakë, se vuante nga reumatizmi. Dhe nusen e kishte të bukur si fijet e barit në mëngjez, kur i mbulon vesa dhe i zë dielli, e të urtë si shqerrë dhe punëtore si vetë Demua. E tillë ishte Selfijazja, që një ditë lindi një djalë të bukur e plot shëndet.

Gjatë kësaj kohe kaluan vite dhe diçka po ndodhete. Ajo revoltë e fshehur në shpirtin e çobanit Demo kishte shpërthyer te të tjerët dhe Demua shikonte se si malet u mbushën me disa njerëz që mbanin një yll të kuq në ballë. Dhe Demua u njoh me ta, dhe çobani Demo u miqësua me ta. Ata i flisin për lirinë, për beun, për të drejtën. Ata vinin e iknin në stanim e Demos. Tani çobani filloi t'ia pakësonte qumshtin beut. Beu u bë si i xhindosur. Dërgoi qehajallarët, por revolta kishte shpërthyer në shpirtin e çobanit. Ai i priti me pushkë. Qehajallarët e beut ikën të tmerruar, një mbeshti i vrarë. Demua mori bagëtinë, i vuri përpara dhe u nis drejt malit, te partizanët.

— Janë delet e beut, shokë, hani mish, se ai na ka rjepur gjithë jetën.

Beu u xhindos. «Çobani ishte arratisur me gjithë bagëtinë. Çobani i kishte vrarë qehajallarët.»

— Do të më njoħésh, Demo Çobani! — u betua beu. Dërgoi njeréz tē vrисnин Selfijazen. E gjetën një natë duke mbushur ujë nē pus dhe e hodhën bren-da. Dhe e mbytēn Selfijazen, gruan e tij tē mirë. Nesimin, tē birin, ia fsheħen fshatarët. Ai ishte kér-thi i vogël. Qau Demua nga tērbimi, mori pushkën dhe u kérkoi lejë partizanëve tē vriste beun.

— Do tē vijë koha — i tha komisari duke i rrā-hur shpatullat.

### 3.

Lufta ishte ndezur e ashpér. Partizanët irrethu-an fshatin e Demos. Demua luftonte si i tērbuar. Shikonte nga larg kullën e beut, që zbardhеt nē mes tē fshatit dhe gjaku i hipte nē kokë. I kujtohej Sel-fijazja.

— Ulu, Demo, nuk luftohet kështu! — i thërriste skuadärkomandanti, një djalosh shpatullgjerë.

Gjermanët ishin përqëndruar nē një kodër. Që-llonin me top. Predhat fluturonin dhe shpérthenin me zhurmë.

— T'u marrim krahët! — urdhëroi komandanti i kompanisë dhe shtoi mbas pak. — Bekim, merr skuadrën e tretë dhe dil nē krahun e majtë tē kodrës!

Tetë vetë u nisën, i teti ishte Demua.

Lufta vazhdonte. Kudo krisma. Erë barot. Urrejtje. Kodra u rrethua nga tri skuadra.

— «Para partizanë!» — u dha sinjali. Tri skua-

drat sulmuan njëherësh. Demua ishte i pari, që u hodh mbi topin gjerman dhe shpoi me bajonetë një nazist. U përleshën trup me trup. Kodra u pushtua. Gjermanët u varën poshtë dhe përforcuan hyrjen e fshatit, disa mbetën të vrarë.

Fshati shtrihej në lugine dhe që nga maja e kodrës dukej si në pëllëmbë të dorës. Lumi, që zbriste nga maja e malit, e ndante fshatin në dy lagje, duke gjarpëruar si me vështirësi midis zajeve të bardha e të lëmuara.

— E kapëm një top, një top gjerman! — gëzoheshin partizanët dhe e shikonin me kurrestje si një qenie të çuditishme. Dikush i kapte grykën, dikush i prekte rrotat, një tjetër mundohej të hapte shulin. Ishte hera e parë që ata kapnin një trofë të tillë lufte kaq të madhe. Secili mundohej t'i merrte vesh «sekretet.»

— Ta qëllojmë me top kullën e beut, me top — se kush foli nga partizanët.

— Po, po, me top! — thirri edhe Demua.

E kthyen grykën nga fshati në drejtim të shtëpisë së beut. Demua kërkonte mekanizmin e shkrepjes.

— Hapu, hapu, Demo! — i thirri Bekimi, duke tërhequr një litar të gjatë. U dëgjua një krismë e fuqishme. Të gjithë mbajtën frymën pezull. Ku do të binte predha? Mbas disa sekondash u dëgjua gjëmi mi i plasjes tutje, në kodrën matanë, shumë larg kullës së bardhë.

— Larg, shumë larg! — thirri Demua — ta mbushim edhe një herë! — dhe skuadra partizane u shndërrua pa e kuptuar as ajo vetë në numrore topi. Ishte një top gjerman i kalibrit 76 mm. me rrota druri e grykë të shkurtër. Çobani hapi një arkë që ndo-

dhej aty afër. Ajo ishte plot me predha. E mbushën përsëri. Bekimi po mendohej: «A duhet ta têrheq litarin? Kjo s'ka kuptim. Gjithë këto vegla që ka ky top, duhen drejtuar», mendonte. Vuri syrin në tej-qyrë. Xhami zmadhues i solli një panoramë të bukur. Lëvizi disa burma, pastaj disa doreza. Pa se me një dorezë gryka e zjarrit ulej dhe ngrivej, kurse me tjetër lëvizte majtas e djathtas.

E rregulluan dhe njëherë topin, pastaj têrroqën litarin. Këtë radhë predha ra afër shtëpisë së beut por, për çudinë e partizanëve, ajo nuk plasi por u fut thellë në tokë.

— Qenka e skaduar e mallëkuara — thirri Demua — edhe një tjetër, shoku skuadërkomandant! Por këtë radhë mbaje pak më lart.

Bekimi lëvizi dorezën dhe gryka e zjarrit u çua lart. Në fshat gjermanët kishin zënë pozicione përfocuese. Në shtëpinë e beut tundej një flamur nazist me kryq të thyer në mes. Kudo dëgjoheshin krisma. Tetë partizanët qëndronin pranë topit. Skuadrat e tjera ishin shpërndarë nëpër pozicione të ndryshme.

— Zjarr! — thirri Bekimi. Këtë radhë litarin e têrroqi Demua. Predha e topit goditi murin e shtëpisë së bardhë dhe këtë radhë ajo, sikur të ishte plumb e jo predhë, hapi vetëm një vrimë të vogël sa diametri i saj, pa shpërthyer.

— Na e paskan punuar maskarenjtë, këto predha qenkan të prishura — foli Demo Çobani i zemëruar, duke qëlluar me opingë rrotat e topit. Skuadrat e tjera ishin shpërndarë nëpër pozicione të ndryshme.

— Mos u mërzit Demo, ta mbushim edhe një herë — i tha Bekimi duke i rrahu shpatullat. Demua e kapi predhën me dy duar në majë. Për çudi

maja lëvizi. Filloi ta rrotullonte dhe ajo doli fare si një kapuç i vogël.

— Pa ta provojmë një herë kështu, se ndoshta pëlçet — u tha shokëve me gjysmëzëri.

E mbushën edhe këtë radhë dhe qëlluan mbi kuillen e beut. U dëgjua një krismë e fuqishme dhe pas pak nga shtëpia e bardhë u ngrit një shtëllungë e dëndur tymi të zi.

— Urra, të lumtë Demo, se ia mësove kleçkën! Këtu mbajeni! Këtu! O burra, ta mbushim edhe një herë! — thirrën partizanët.

Demua u hiqte kapuçin predhave si njeri i «zananatit», pa kuptuar kështu se luante rolin e graduesit. Bekimi lëvizte mekanizmin e drejtimit dhe të naltësimtit.

— Zjarr!

— Zjarr!

Kulla e beut nxirrte tym e flakë që ngriheshin drejt qiellit. Flamuri nazist ishte rrëzuar përtokë i shqyer. Pas pak në qìell ndriçoi një raketë e kuqe. Ishte sinjali për sulm. U dëgjuan urra të forta dhe partizanët sulmuan fshatin. Vetëm skuadra e tretë vazhdonte të qëllonte me top kullën e beut. Demua qëndronte gati me predha në dorë. Balli i ishte mbuluar nga djersa dhe baroti. Dielli, që ishte ngritur gati mbi majën e malit, lëshonte në fshat disa rreze të pjerrëta duke projektuar figura të çuditshme mbi lumë, që ngjante si një brez i përgjakur.

Kështu Demo Çobani u bë gradues i topit. Tetë partizanët shkonin pas batalionit dhe kudo me vete, si gjithmonë merrnin topin gjerman. Ai u bë një pjesë e pandarë e tyre. Dikush nga shokët e batalionit, që kishte qenë artilier në batalionin «Tomorri» u mësoi se si përdorej dhe me atë vullnetin që karakteri-

zonte vetëm partizanët, i mësuantë gjitha «sekretet». Por vetëm Demo çobani ndjehej më i lumturi nga të gjithë këta», sepse ishte ai i pari që zbuloi «sekretin» e predhës dhe u bë gradues.

— 4 —

— Xha Adem, paske dëshirë të bëhesh shenjues — i foli komandanti i baterisë duke e shkundur nga mendimet. Plaku, i zënë në befasi, nuk diti si t'i përgjegjej.

— Po, ju thashë që topi ka mbetur pa shenjues, Aliu qenka në spital — dhe, pasi heshti pak, shtoi me gjysmë zëri, si me turp:

— Shoku komandant, po sikur të mësoja dhe unë pak për shenjues?!

— Po, xha Adem, të mësoj unë! — e mirëpriti komandanti kërkesën e ushtarit të vjetër duke qeshur dhe filloj t'i shpjegonte çdo gjë nga e para me durim. Plaku e dëgjonte me vëmendje pastaj lëvizte shenjestren.

— Edhe detyrën e shenjuesit po e mëson, o xha Adem? — e pyeti Ganiu, mbushësi i topit të parë.

— Po, more Gani, po kujtoj disa gjëra, se unë të mësuara i kam pasur — u përgjegj plaku duke lëvizur shenjestren tërë seriozitet.

— Që nga koha e luftës?

— Po që kur, nga koha e Nojes?

Numroret qeshën.

— E ku ka patur atëhere armë të tillë moderne, mor xha Adem — i tha Ganiu — ti vetë na ke thënë se ke luftuar me një top me rrota druri.

Ushtarët e shihnin me dashuri, por plaku nuk e kishte mendjen tek ata. E kishte mendjen te shenjestra.

## VAJZAT DHE USHTARI

Ushtar Artani arriti në agjensinë e vogël. Te sporteli kishte shumë njerëz që nguteshin të merrnin biletat e udhëtimit. U fut edhe ai midis tyre.

— Ngadalë, more shoku ushtar, ngadalë, se na shtype — dëgjoi zërin e një vajze flokëverdhë. Pantallonat e saj ngjyrë mjalti dhe shalli i aksionit lidhur qafës së rreshkur nga dielli tregonin se ishte vullnetare e hekurudhës. Me biletat në dorë Ardiana iu afroa shoqes:

— Ke parë ti. Shtyn tjetri me sa mundet pa pyetur se ka të tjerë përpara.

— Jo, Ardiana, m'u duk se e fyeve kot! Ai as të preku fare — i tërhoqi vërejtjen Lili.

— Ua, dhe ti Lili, ai gati sa s'më zuri frymën. Shiko sa i madh është — dhe të dyja hodhën vështrimin nga shpatullat e gjera të ushtarit që po largohet nga sporteli me biletë në dorë. Djali ktheu kokën nga vajzat, deshi t'u fliste diçka, por pastaj ndërrroi mendim.

«Ndoshta do të jetë fyer», mendoi vajza zeshkane, «e megjithatë nuk foli». Pastaj iu kthyesh shoqes:

— Ti gjithnjë rrëmbehesh, Ardiana. Të kam thënë edhe herë të tjera, që të mos ngutesh. Të kishte qenë ndonjë tjetër, kushedi ç'përgjegje do të të jepte.

Ardiana nuk foli. Fytyrën ia kishte mbuluar një ngjyrë e kuqe si e shegës. Sytë larushë i nguli në tokë. E kuptoi se ishte ngutur, prandaj hodhi vësh-



trimin andej nga iku ushtari, si kur deshi t'i kërkonte falje.

Një «ZIS» qëndroi në anë të rrugës.

— Maqina për Tiranë — thirri nga brenda sportit arkëtarja.

Një plak hapi derën e kabinës dhe u ul pranë shoferit. Ardiana me Lilianën u ngjitën në karroceri, ku kishte zënë vend edhe ushtari. Ardiana u skuq për një çast, deshi t'i fliste, t'i kërkonte të falur, por nuk dinte nga t'ia fillonte. «Ta pyes ku do të shkojë, apo..?»

Liliana i binte me bërryl.

Motori i maqinës lëshoi një zhurmë të çjerrë dhe rrotat çanë përpëra në asfalt.

Kaloi më se një orë që po udhëtonin. Në karroceri kishte rënë heshtje. Vetëm herë pas here dëgjoheshin zërat e hollë e të ulët të vajzave, që se ç'tregonin midis tyre, duke i hedhur ndonjë vështrim të shpejtë fytyrës së menduar të ushtarit.

Dielli u fsheh prapa një reje të murrme, pastaj doli përsëri. Re të tjera po grumbulloheshin, duke iu afruar njera-tjetrës.

— Do të bjerë shi — e theu heshtjen e para Ardiana.

Dhe vërtet, pas pak qelli u nxi. U dëgjua një shkrepëtimë. Pas saj gjëmimi i përsëritur i bubullimës u tret larg në thellësi të luginës. Disa pika të mëdha shiu, si lajmëtare të rrebeshit që do të fillonte, ranë mbi karrocerinë e maqinës. Vajzat u ngjeshën njera pranë tjetrës për t'u mbrojtur më mirë. Ushtari rregulloi bustinë dhe futi poshtë gjunjëve çantën e shpinës.

Maqina ndaloj. Shoferi doli nga kabina dhe hodhi mbi karroceri një mushama të vjetër.

— Mbulohuni, moj çupa, mbulohuni, se do të lageni. Afrohu dhe ti, o bir! — iu drejtua ai ushtarit.

— Jemi mësuar ne me shi, le që ky është shi

vere dhe të freskon — i tha ushtari duke i buzë-qeshur shoferit.

Maqina u nis përsëri. Shiu i rrëmbyer u dendësua. Liliana e ftoi ushtarin në mushama, por ai buzëqeshi dhe tundi dorën në shenjë mohimi.

Asfalti i rrugës shkëlqente nga të lagurit, kurse vende-vende ishin formuar pellgje me ujë. Poshtë, paralel me rrugën automobilistike rrëshqiste lumi i fryrë nga ujet. Maqina çante përpara. Vajzat të mbështjellura me mushama herë pas here hidhnin vështrime nga ushtari. Pikat e ujit i binin mbi bus-tinë, i rrëshqisnin mbi faqe dhe i grumbulloheshin në gropëzën e vogël të mjekrës, pastaj rrëshqisnin poshtë.

Ardiana i hidhte vështrime të fshehta dhe mendonte.

«Ndoshta për ushtarët shiu është diçka e zakon-shme».

Shiu tashmë kishte filluar të rreshej. Rizonte imtë. Ato dolën nga mushamaja.

— Fshihuni, shoku ushtar, ju jeni lagur — i tha Ardiana duke i zgjatur një shami të madhe dhe nga turpi uli kokën.

Kur ngriti sytë dhe vështroi ushtarin, ai për çudi, sikur të mos e kishte marrë fare inat përfjalët e pamatura që i tha ajo të sporteli i agjencisë, i buzëqeshi. Vajzës iu duk sikur një pjesë e dëshpërimit, që e kishte pushtuar, iu zhduk nga kjo buzëqeshje e singertë.

Maqina dukej sikur fluturonte. Shoferi, i pasuar nga plaku, nisi të këndonte një këngë popullore. Dukej që e ndjente veten të gëzuar. Edhe në karroceri tashmë ishte hapur një bisedë e ngrohtë midis vajzave dhe ushtarit.

## KOLLOVARI

### I

Një ditë shiu ajo kishte hipur në maqmën e tij. Atë ditë Etleva kishte marrë pjesë në aksionin për mbjelljen e pemëve. Edhe Stavri kishte punuar aty, transportonte fidanet.

Etleva rrinte e heshtur dhe e drojtur në sediljen e kabinës. Ndiqte me bisht të syrit lëvizjet e duarve mbi timon dhe vështrimin e shoferit. Maqina rrëshqiste me shpejtësi mbi asfaltin e lagur dhe ai vërshëllente një melodi të këndshme.

— Si të quajnë?

— Etleva.

— Më quajnë Stavri.

Ai kishte dëshirë të bisedonte, ndaj i bëri pyetjen e dytë, por ajo bëri sikur s'e dëgjoi. E dinte se shoferët janë shumë «çapkënë», ndaj nuk donte të hapte bisedë. Ai filloi të vërshëllente dhe pas çdo kthese i binte borisë. Në këto çaste, ajo ngrinte vështrimin dhe e shikonte e habitur, por pa folur, gjithnjë e drojtur dhe e përbajtur. Ai e kuptoi se vajza druhej që kishte hipur në kabinën e maqinës vetëm me të. Nuk vërshëllente më, borisë i binte

më rrallë, vetëm se pasqyrën e ktheu pakëz nga vetja.

— Arritëm.

— Falem nderit! Drekën e mirë! — i tha ajo dhe, pasi zbriti, mbylli derën.

Stavri mbeti vetëm në maqinë. Vështroi në rru-gë. Vajza me sy të kaltër tashmë kishte hedhur belin në sup dhe ecte, duke mos e kthyer kokën prapa. I erdhi t'i binte borisë e të thërriste: «Etleva, Etleva», por vetëm buzëqeshi dhe i shkeli gazin maqinës.

\* \* \*

Dera e rrobaqepësisë u hap dhe një grup vaj-zash vërshuan në rrugë. Stavri ndjeu në gjoks të rrahurat e shpejta të zemrës.

Etleva sykaltër po i afrohej pemës ku qën-dronte ai. Ajo i hodhi një vështrim djaloshit dhe i buzëqeshi si gjithmonë. Ai i preu rrugën.

— Etleva, më falni, ju lutem, por... desha...  
Vajza qëndroi.

Me bishtin e syrit ajo ndoqi lëvizjet e tij. Ai iu afrua me fytyrën të skuqur nga emocioni, i tha:

— Dëgjo, Etleva, unë nuk di të flas shumë. Ne shoferët themi hapur ato që mendojmë. Që nga ajo ditë, kur të pashë për herë të parë, kam filluar të ndjej diçka për ty. Të... dua, Etleva. Kaq kisha! — tha ai e i ra me grusht pëllëmbës së tij të mëdhe dhe të ashpër, sikur u çlirua nga një barrë e rëndë.

Vajza kishte ulur sytë poshtë dhe s'fiste. Djaloshi priste me ankth. Ai e kapi nga krahu dhe i foli përsëri:

— Kaq tē zorshme e ke tē përgjegjesh? Më thuaj, po, ose jo! Jam matur edhe disa herë tē tjera tē tē flas, por...

Etleva ngriti sytë. Vështrimi i saj ishte i ëmbël dhe plot mirësjellje.

— Do tē tē pyes pér një gjë — foli më në fund vajza e vendosur.

— Po dëgjoj!

— E ke vendosur?

— Po!

— Nuk tē duket se po ngutesh? Ne s'kemi shumë kohë që njihemi. Nesër ti ndoshta mund tē dëgjosh pér mua fjalë nga tē tjerët.

— Dëgjo, Etleva, unë nuk pyes tē tjerët pér dashurinë time. Unë pyes zemrën. Ajo më thotë se tē dua. Le tē thonë ç'të duan tē tjerët pér ty.

I hodhi dorën në qafë me dashuri. Nga afër ndjente frymëmarrjen e saj tē ngrohtë.

S'shkoi shumë kohë dhe u fejuan.

## II

— Stavri, këtu nuk ka asgjë tē keqe, ti...

— Si nuk paska, tē hyj dhëndërr brenda qenka gjë e mirë? Të bëhem kollovar dhe tē më thérresin bota «Stavri kollovari?» Të bukur emër dashke tē më vesh — e ndërpree ai i zemëruar duke nxjerrë nga xhepi paqetën e cigareve. Era që frynte nga lindja ia shoi shkrepsen dhe ai i nevrikosur e flaku tutje në rrugë me gjithë cigare.

— Stavri, t'i dëshitet tē me kuptosh. Unë vetëm



ata prindër kam. Fundja, kush do të banojë me ta pasi të martohem?

— Nuk më intereson asgjë. Burri e merr gruan në shtëpinë e tij kur martohet. Pastaj edhe unë kam prindër!

— Ti ke edhe dy vëllezër të tjerë. Ata do ta kuptojnë shumë mirë gjendjen tonë.

— Mirë, ja e kuptuan ata. Po bota ç'do të thonë? E mori gruaja burrin në shtëpi. Stavri u bë kollovar. Kollovar! — përsëriti ai, me një përqëmim që binte në sy menjëherë.

— Dikur ti thoshe se 'pak të interesonin ato, që thonë bota, përderisa ne duhem — i thoshte Etleva me vendosmëri, duke e kapur nga krahu. — Ne do të krijojmë familjen tonë, fëmijët tanë. S'na hyjnë në punë thashethemet e botës.

Ata ecnin. Ai s'fiste. Muzgu i mbrëmjes kishte zbritur në qytet dhe në vitrinat e dyqaneve u ndezën dritat e para.

— Folë, Stavri, a më dëgjon? — e shkundi ajo nga mendimet.


— Ç'të flas? Ta thashë një herë. Nuk bëhem kollovar unë, pikë mbaroi!

Etlevës i vinte pér të qeshur, sa herë që Stavri në fund të çdo fjale përsëriste: «pikë mbaroi». Por sot nuk ishte rasti pér një gjë të tillë, ndaj e vësh-troi me qortim.

— Ti nuk arësyeton drejt, Stavri.

— Ashtu të duket ty, se s'do të ndahesh nga prindërit. Po dhe unë dua shtëpinë time, qetësinë time që, me sa po shoh, s'të intereson fare.

— S'ke turp, Stavri! Nuk i prisja nga ti këto fjälë, por ti... — Nuk e mbaroi fjälën. Mezi e pér-



mbante veten. Ajo vrapi në rrugën e gjerë dhe pas pak u zhduk në një kthesë.

Stavri mbeti në vend i hutuar. Nuk e merrte me mend se do të ndodhë ashtu. Ai e dashuronte Etlevën. Së shpejti do të martoheshin. Si duket ai u ngut, kur i tha ato fjalë. E po ç'nuk thotë njeriu, kur është i inatosur. Filloi të vraponte pas saj. Por qëndroi përsëri. Iu rikujtua pse ishin grindur.

«Të hyj dhëndërr brenda?! Të bëhem kollovar?! Kollovar..?»

U kthye. Hapi derën e kabinës dhe hyri në maqinë. Ndezi motorin. Maqina u lëshua me shpejtësi në rrugë. Uturonte, merrte kthesat, ndërsa siluetat e errëta të pemëve kalonin me shpejtësi njera pas tjetrës, të ndriçuara nga prozhektorët. Nga kor skoti i kabinës fotografia e Etlevës i buzëqeshte ëmbël me sytë e kaltër, që dukeshin sikur i thoshin:

— «A nuk është qesharake të mendosh gjëra të tilla, Stavri?»

I dha gaz maqinës, dhe maqina filloi të lëvizë në fillim me plogështi pastaj me shpejtësi andej nga qe zhdukur Etleva.

## BUZË DETIT

— Ej, Beni, më ndiq! — tha ajo dhe u zhyt në ujët e kaltër të detit. Valët nanurisnin lehtë bre-gun shkëmbor. Filloi të notonte përpara me lëvizje të shkathëta. Arbeni shikonte trupin e zhdërvjellët në kostumin e kuq të banjës dhe krahët ngjyrë çokollatë, që shpalosnin ujët me një shkumë të bardhë...

— Beni, pse s'më ndjek? — u dëgjua përsëri si një jehonë e largët zëri i saj.

Lëmshi i kuq i diellit po zhytej në thellësitë e detit, duke përflokur ujët me një ngjyrë të purpurt. Tutje, Karaburuni kishte zgjatur krahun e gjatë midis detit sikur donte të tregonte me gisht ishullin e vogël të Sazanit të veshur nga një mjegull e hollë e transparente.

Ajo dukej si një pikë e vogël që zhdukej në thellësi. Arbeni u bë gati të hidhej në det, kur një zë i foli nga prapa:

— Ju jeni oficer Arben Bardhyli?

Arbeni ktheu kokën. Prapa tij qëndronte një djalë i ri me robe banje.

— Po! — u përgjegj qetë.

Đjaloshi kryqëzoi duart në gjoks, sikur donte tē tregonte kështu më mirë trupin e tij prej atleti dhe pyeti përsëri:

— Që kur keni filluar t'i shijoni limonat e shtrydhur?

Oficer Arbeni u hutua nga kjo pyetje dhe s'e kuptonte ç'ishin këta limona tē shtrydhur, tani në muajin e fundit tē verës.

— Më falni, nuk po ju kuptoj — kërkoi sqarim ai.

— Keni tē drejtë. Po ju flas hapur. E kam fjalën pér Ermirën.

— Pér tē fejuarën time?! — tha Arbeni dhe ndjeu gjakun t'i hipte në fytyrë.

— Tani është e fejuara juaj, po në fillim ka qenë e dashura ime.

— Si guxoni?! — thirri Arbeni duke e kapur me forcë nga krahu.

— Guxoj në emër tē drejtësisë. Ajo më tradhëtoi mua dhe erdhi me ju. Por edhe juve mund t'ju ikë një ditë. Ju këshilloj t'i shkëpusni marrëdhëniet me këtë vajzë, ju jeni dhe ushtarak. Kaq kisha.

Kur ngriti kokën Arbeni, ai po ikte me vrap. Oficeri i ri mbeti krejt i shtangur nga ajo bisedë aq e çuditshme. I erdhi ta thërriste atë djalë me flokë tē gjatë, që i fliste në emër tē «drejtësisë», t'i thoshte se asgjë s'ishte e vërtetë, por prapë diçka filloj ta shqetësonte. E megjithatë nuk donte tē besonte. Si tē bënte? T'ia thoshte Ermirës apo jo?

Ktheu kokën nga deti. Mira po kthehej në breg.

— Sa i lig që je — i tha ajo me një ton përkë-dhelës duke dalë nga ujët. — Pse s'më ndoqe? I lig je, i lig. Kam faj unë që u ktheva!

...Një vapor i madh po i afrohej portit duke vë-



shëllyer mbytur. Të dy kthyen kokën duke shoqëruar lëvizjet e vaporit dhe vazhdën e bardhë që linte pas. Arbeni rrinte kokulur dhe nuk fliste. Mira iu afroa e i vuri dorën në sup.

— C'ke kështu, Beni, ty sikur të janë mbytur gjemité?! — tha ajo duke qeshur dhe hodhi përsëri vështrimin nga vapori.

— Asgjë.

— Ti ke diçka.

— Kur e kupton që kam diçka, pse nuk fillon e para? — foli më në fund nervoz djaloshi.

— C'të filloj?

— Ke frikë?

Ajo e kapi nga dora dhe e ndali. Të dy qëndruan përballë njëri-tjetrit. Deti zhurmonte. Valët përplasheshin me njëra-tjetren dhe zgjateshin në breg duke u lagur këmbët. Dy pulëbardha uleshin e ngriheshin mbi valët sikur vallëzonin.

— Folë hapur, Arben, ti diçka fsheh — foli vajza e vendosur.

— Unë do të thosha se kjo e fshehtë qëndron te ti, dhe pres të flasësh ti.

Ajo i lëshoi krahun dhe të dy filluan të ecnin në heshtje. Ecnin duke lënë prapa gjurmët e këmbëve në rërën e lagur.

— Gjithmonë kam qenë e singertë me ty, Arben

— e theu më në fund heshtjen vajza.

— E singertë duke më fshehur dashurinë tën-de të parë? — shpértheu Arbeni.

— Unë njoh vetëm një dashuri, prandaj mendohu mirë kur flet!

— Jam menduar shumë mirë — iu përgjegj Arbeni. — Mbrëmë më the se po bisedoje me një djalë të vogël që kishte humbur të atin, kurse na

doli se po bisedoje me një djalë të rritur, që kishte humbur të dashurën.

Tani Mira e kuptoi se ku qëndronte puna.

...Mbrëmë Arbeni hyri në një lokal për të marrë një paketë cigare. Mira po e priste jashtë në lulishte. Nga errësira doli një hije dhe iu afrua.

— Ç'doni nga unë, pse më ndiqni pas? — i foli ajo ashpër.

— Unë ju dua, Mira! — i foli hija.

— Hiqmu sysh! Ta kam thënë dhe herë të tjera. Unë jam e fejuar... Më lë të qetë!..

— Me atë oficerin? — e pyeti hija. — E ç'lumturi do të të sjellë ai, a e kupton këtë? Me mua do të jesh vërtetë e lumtur.

Iu afrua dhe e kapi nga krahu.

— Largohu, se do të thërras! — e shtyu ajo me forcë.

— Ti do të pendohesh për këtë! — i tha ai me zemërim.

Arbeni doli nga lokalit dhe po e kërkonte me sy Ermirën. Ajo vrapi dhe e kapi nga krahu. Zemra i rrihte nga tronditja dhe fytyra i kishte marrë një ngjyrë të kuqe.

— Ç'ke kështu? — e pyeti Arbeni.

— Asgjë.

— Me kë po bisedoje?

— Një djalë i vogël kishte humbur të atin — gënjeu ajo dhe u skuq përsëri në fytyrë. Nuk deshi t'ia thoshte të vërtetën për të mos e tronditur.

— Ti i beson një rrugaç — foli vajza me nervozizëm dhe e ndjente së një lëmsh po i mblidhej në grykë. Sedra e saj ishte fyter rendë. Por më tepër i vinte inat me Benin. Ai s'kishte besim në dashu-

rinë e saj, kjo e shqetësonte vajzën dhe e hidhëronte njëkohësisht.

Vajza eci përpara. Arbeni e arriti dhe e kapi nga krahu:

— Për çdo gjë ti duhet të më kishe treguar!

— Kushdo që do të guxonë të më prekte, do t'i tregoja vendin. I kam aq forca, sa ta mbroj vetë dashurinë time. Por, ti, Arben...

— Çfarë unë?..

— Po, po, ti... — tha vajza e vendosur — nuk ke besim në dashurinë time.

Arbeni nuk fliste por herë pas here godiste me këmbë kodërザ e vogla të rërës që kishte formuar deti. Atë përsëri e brente dyshimi.

— Ti nuk po më thua të vërtetën — i tha përsëri Arbeni.

— E ç'të vërtetë kérkon ende?

Vajza po humbte durimin. Jo, nuk mund ta duronte, që ai të sillej në atë mënyrë. Filloi të vraponte.

— Ku po shkon? — i thirri ai nga prapa. Vajza nuk iu përgjegj. Arbeni u bë nervoz dhe e kapi nga krahu.

— Ty të them, më dëgjon apo s'më dëgjon? Kështu sillesh ti me burrin? Së shpejti do të mar-tohemë por, po të bësh kështu, sipas kokës tënde, çdo gjë mbaron midis nesh!

— Lëshomë, se dua të shkoj në dhomë!

— Nuk ke për të vajtur!

— I kam rrabet ujë — dhe iu shkëput nga dora.

— Unë të them jo! — dhe djali i zemëruar ngriti dorën. Dora i mbeti si e ngrirë në ajër. Vajza u step.

Nuk mundi të vazhdonte më gjatë. U shkëput

nga ai dhe me lotët që i rigonin faqeve vrapoi për në dhomën e hotelit.

Iku...

Oficeri i ri uli dorën dhe qëndroi në vend pa ditur ç'të bënte. T'i shkonte pas, apo... Mos vallë çdo gjë mori fund? «Pse u nguta kaq shumë? Sot ishte dhe dita e fundit e plazhit. Nesër do të iknim»

Shtrëngoi grushtat.

I dukej vetja fare i vogël. Si arriti deri aty? Çdo gjë i dukej e pabesueshme.

«Iku», psherëtiu me një fije zëri dhe nga dëshpërimi shtrëngoi përsëri grushtat. Valët e detit përplaseshin me zhurmë në breg. Më në fund u nis për në dhomën e tij. Dhoma ishte e errët dhe ai nuk e ndezi dritën. Edhe në dhomën e vajzës nuk kishte dritë. Deti oshëtinte me zhurmë. Nga lindja frynte një erë e ngrohtë. U ngrit, mbylli dritaren.

Në mëngjez e kërkoi, i thanë se vajza kishte ikur...

## II

Arbeni vuante shumë. Vëtmia e kohëve të fundit e kishte bërë ta gjykonte veten më ndryshe dhe të ishte më gjakftohtë në arësyetime.

«Gabova, gabova!» — dhe me hapa të shpejtë lëvizte nëpër dhomë. Mos Ermira kishte të drejtë? Pse, a nuk di ta mbrojë vetë gruaja nderin e saj?»

Ai vagabond e kishte gënjer, kur i kishte thënë se kishte të bënte me Ermirën. Ai e kishte parë atë vetëm në plazh dhe i ishte qepur disa herë prapa.

Prandaj Arbenit i vinte inat. T'ia kishte treguar Mira me kohë, do t'ia kishte shtypur kokën atij rrugaçi. Po pse vetë Mira nuk ia kishte treguar vendin?

«Ç'jemi dhe ne djemtë. Po sikur ajo vërtet të kishte dashur një djalë para disa vjetësh, kur ne nuk ishim njobur ende, a do ta doja vallë? Pse ne kërkojmë gjithmonë që vajza të jetë e kulluar?».

Ermira ia kishte treguar të vjehrriit ndodhinë e plazhit me Arbenin. Xha Ademi ishte revoltuar shumë nga sjellja e të birit.

— Turp të ketë — i pat thënë vajzës — i rroftë shkolla! Ku e gjeti ai këtë të drejtë mbi ty?

Ndërsa Ermira ndjente dashuri dhe keqardhje për Arbenin. Ajo e dashuronte dhe këtë e thoshte me plot gojën, por vuante, kur kujtonte se edhe ai kishte ndonjë mendim të vjetëruar në kokë duke shprehur një mosbesim të hapur ndaj dashurisë... Megjithatë e dinte se Arbeni do të pendohej dhe do t'i kërkonte falje, por s'ishte e lehtë.

Arbenit ditët i kalonin të mërzitshme. Si gjithmonë në fillim të vjeshtës pemët rrëzonin gjethet e verdha. Në zyrë nuk i rrihej, punë nuk i zihej me dorë. Era e ftohtë që frynte nga veriu ia shpaloste cepat e kapotës.

Në rrugë kalimtarët e rrallë ecnin me hapa të shpejtë. Një grup të rinjsh po vraponin drejt derës së kinemasë. Kështu vraponin edhe ata, kur ishin të dashuruar.

Duke menduar, këmbët e shpunë drejt pallatit të saj. Po shkonte t'i kërkonte të falur? Ndoshta...

Dhoma e saj kishte dritë. Zemra filloi t'i rrihte me forcë sikur po shkonte për herë të parë në takim. U fsheh pas trungut të një peme se nuk donte

ta shikonte njeri. I dukej e çuditshme, para pak ditëve shkonte e vinte në shtëpinë e saj, kurse tani i vinte turp të ngjiste shkallët.

«T'i férshëllej si dikur», mendoi me vete. «Po të më dojë ende, ajo do të dalë në ballkon.»

Férshëlleu melodinë e njohur.

Dera e ballkonit lëvizi lehtë.

## LULJETA

Marku e përçollti deri në qendër të lokalitetit. Ajo, pasi u përvendet me të, zuri vend në autobus.

Maqina u nis. Djali ende qëndronte pa lëvizur dhe shihte fytyrën e saj të zeshkët përmes drithares së autobusit. Ajo i tundi shaminë e bardhë derisa djali i humbi nga sytë.

Po bëhej një kohë e gjatë që nuk kishte qenë në shtëpi, prandaj takimin me prindërit dhe vëllanë e vogël, Ilirin, e priste me padurim.

Tirana i doli përpëra ashtu e bukur dhe e zhurmshme si gjithnjë, me rrugët plot njerëz dhe maqina, me vitrinat e zbukuruara të dyqaneve, me neonet e shumta dhe me sheshin e gjerë, ku ngrihet monumenti i Skënderbeut.

Kaloi me të shpejtë bulevardin e madh. Nga pasticieri «Peza» disa vajza moshatare të saj dolën duke ngrënë akullore. U hodhi sytë se mos shihte ndonjë shoqe pastaj, kur pa se nuk njihte asnjerën, mori rrugën e Durrësit nga kishte shtëpinë...

Marija e përqafroi dhe nisi ta puthte me mall të bijën.

E përqafroi edhe i ati, edhe Iliri i vogël, që kërkonte t'i hapte valixhen e të shihte se çfarë i kishte sjellë e motra nga fshati.

Luljeta ndjeu aromën e shtëpisë. U shtri në krevatin e saj duke pasur në mendje fytyrën e Markut.

Ajo donte ta hapte bisedën. Për këtë ishte e vendosur. Dashuria për Markun i jepte forca të mëdha.

— Baba... — mezi mundi të shqiptonte më në fund një natë, kur së bashku me prindërit ishte ulur në tryezë për të biseduar — atje në fshat... jam njobur me një... djalë... E quajnë Mark...

I ati e dëgjonte me vëmendje. Marija kishte vënë duart në faqe si për t'u pregetitur për turpin që mund t'i tregonte e bija.

— Me Markun kemi vendosur të fejohemi. Jemi njobur mirë me njëri-tjetrin. Dua edhe pëlqimin tuaj...

— Pupu, moj korbë! — shpërtheu e ëma — të martohesh në fshat?.. Sa herë të thamë, kur të nisëm: «Vajzë, hap sytë, mos na turpéro! Se mos gënjejesh me ndonjë çunak dhe mbetesh andej pastaj». Ja tani na e paske bërë gjëmën!

— Po ç'të keqë ka këtu, moj mama. Njeriu e krijon lumturinë, atje ku gjen dashurinë.

— Kur u bëre ti për dashuriçka, moj? Pse, ato që u fejuan dhe u martuan pa dashuri, këq e patën? Kanë ardhur shumë njerëz për ty.

I ati nuk fliste. Ai gjithnjë i peshonte fjalët para se t'i nxirrte nga goja. Më në fund iu drejtua së bijës me ton atëror:

— Ndoshta unë gabohem, bija ime, por më duket se je nxituar. Të pret një e ardhme e lumtur. Ke bërë 12 vjet shkollë. Mendohu edhe një herë. Bisedojmë përsëri nesër. Tani shko e shtrihu. Natën e mirë!

...Duke parë pejsazhin e bukur që iu shfaq përpara, Luljeta ndjeu diçka t'i pushtonte trupin.

Fshati verior, i futur mes grykave të maleve, me shkëmbinjtë e thepisur e të mbuluar me dëborë, e ftonte nga larg. Shtëpitë karakteristike të ndërtuara me gurë, të larta, me frengjité e ngushta e çatitë e pjerrëta, ishin të shpërndara si yjet në qiell. Një erë e lehtë, që frynte nga lindja, tundte degët e zverdhura të pemëve që fëshférinin dhe pastaj shkrihej me tingëllimën e këmborëve të bagëtive.

Luljeta hyri në fshat me valixhen në dorë dhe trokiti në shtëpinë e parë që hasi në atë rrugë të panjohur.

U dëgjua e lehura e një qeni, pastaj dera kërciti dhe në të u duk figura e një plaku me qeleshen e bardhë në kokë.

— Bujrum, o mik, bujrum!

— Jam mësuesja e re e fshatit — mezi mundi të shqiptonte vajza — desha...

— O, mirë se erdhe, shoqja mësuese, mirë se erdhe! — dhe plaku e rroku në qafë. — Ka kohë që po të presim. Vocrrakët nuk po na lanë rehat fare. Urdhëno, urdhëno!

E futi vajzën në një dhomë të vogël në krye të shtëpisë. Dhoma ishte e thjeshtë, e pastër dhe me disa orendi të vogla.

— Këtu rrinte edhe mësuesi tjetër që na iku ushtar — i foli me përzemërsi xha Martini vajzës duke i rrahur shpatullat.

Luljeta e falënderoi për kujdesin dhe pritjen e ngrrohtë.

— Oj Dilë, Dilë moj! — thirri plaku duke dalë në krye të shkallëve. — Hajde, se na ka ardhë mësuesja e re!

Nuk vonoi dhe Dila, e zonja e shtëpisë, u duk te praku i derës. Ishte një malësore me trup mesatar, me shami të bardhë në kokë nga i dilte një culufe e argjendë flokësh, me një fytyrë të rreshkur dhe me dy sy të gjallë ngjyrë bari.

— Mirë se erdhe, shoqja mësuese! — tha ajo dhe e rroku në qafë sipas zakonit të malësorëve.

Pasi pleqtë mikpritës dolën nga dhoma, Luljeta u shtri në krevatin prej dérrase mbuluar me një kuvertë të bukur dhe mbështeti kokën në jastëkun e bardhë.

Mendimet e çuan në qytetin e lindjes, në Tiranën e madhe në rrugët e saj plot zhurmë. Iu kujtuan prindërit. Shkolla Pedagogjike. Tani ajo ndodhej qindra kilometra larg tyre, në një vend të panojohur, por që së shpejti do të bëhej i dashur për të.

Me këto mendime i mbylli sytë larushë nën qepallat e bukur.

Nënë Dila hyri me kujdes në dhomë duke sjeillë një krah me shkarpa, ndaloi përpara mësueses së re, e mbuloi me kuvertën dhe pastaj ndezi zjarrin.

Jashtë muzgu i mbrëmjes po hidhte mbi superrobën e zezë të natës. Flladi i freskët, që zbriste nga malet, përplasej pas kanatave të dritareve, thuhajse donte të hynte me forcë brenda në dhomë.

Të nesërmen Luljeta u pregatit për mësimin e saj të parë.

\* \* \*

Kur hyri në klasë, fëmijët u ngritën më këmbë dhe e përshëndetën njëzëri:

— Mirë mëngjez, mësuese!  
— Mirë mëngjez, fëmijë! — u përgjegj ajo dhe  
buzëqeshi.

Fëmijët u ulën. Luljeta hapi regjistrin.

— Pal Jaku!

— Këtu!

— Shkurte Miri!

— Këtu!

— Mirë dita! — dëgjoi një zë t'i fliste nga pra-  
pa. Mendimet iu ndërprenë.

Ngriti kokën. Para saj qëndronte një ushtar i  
liruar, pa rrip mesi e pa bustinë në kokë. Flokët  
gështenjë i kishin rënë mbi ballë, sikur t'u bënин  
strehë syve të zinj, nën qerpikët e dendur. Ai bu-  
zëqeshte.

«Marku», tha papritur me vete mësuesja, «djali  
i xha Martinit». Ai i kishte folur shpesh asaj pér  
djalin, që lirohej ato ditë.

— Mirë se erdhe, Mark! Të gjithë të presin.  
Xha Martini do të gëzohet shumë.

Ushtari i liruar ngriu nga habia.

Po kjo vajzë e panjohur nga ia dinte emrin?!

— Desha të takoja pak mësues Petritin, ju lu-  
tem! — tha më në fund ai.

— Petriti ka disa ditë që është nisur ushtar.  
Unë jam mësuesja e re që kam ardhur ta zëvendë-  
soj. Bile banoj në shtëpinë tuaj. Xha Martini më  
ka folur pér ju, Mark. Kështu që nuk mbetet gjë  
tjetër veçse të njihemi. Më quajnë Luljeta Nako —  
dhe i zgjati dorën.

Ushtari e shtrëngoi atë dorë të bardhë e të bri-  
shtë midis pëllëmbëve të ashpra.

— Gëzohem shumë, Luljeta! Edhe Petriti në

shtëpinë time banonte. E kam 'pasë shok të ngushtë.  
Buzëqeshën të dy.

...Xha Martini e përqafoi i pari të birin dhe e  
puthi në ballë. Pastaj me radhë nënë Dila, hallë  
Prenda e të afërmit e tjerë.

Në fund Marku u ul në një fron, i hodhi një  
vështrim mësueses dhe pastaj u kthyte nga xha Mar-  
tini:

— Bacë, paske ba mirë që e ke mbajtë mësue-  
sen në shtëpinë tonë.

— Besa, edhe sikur të mos donte, kisha me e  
mbajtë me zor — qeshi plaku dhe pastaj shtoi: —  
E kena mësuese të mirë.

\* \* \*

Themelet e kabinës elektrike ngjiteshin gjith-  
një e më lart.

Të rintjtë e të rejat e kooperativës me në krye  
Markun gjendeshin në valën e punës. Kishte ardhur  
edhe Luljeta me nxënësit e shkollës për t'i ndihmuar  
në aksionin e madh.

Një ditë, kur po punonin së bashku, Luljeta  
ngriti me vështirësi një gur të madh që ta vendoste  
në skelë.

— Do të rrëzohesh — i thirri Marku dhe u  
afrua menjëherë për ta ndihmuar. Ajo atë çast ishte  
në rrezik të rrëzohej me gjithë gur. Djali ia mori  
gurin nga dora dhe ia nguli sytë ftyrës së saj të  
pastër. Ndenjën disa çaste ashtu pa lëvizur me gu-  
rin në mes. Ftyrat u ishin skuqur...

Në darkë, kur po kthehet e shtëpi dielli ki-  
shtë perënduar. Ecnin të dy pranë njëri tjetrit. Një

ndjenjë e përbashkët i kishte pushtuar ndaj dhe ecnin ndryshe sot.

Ajo qëndroi. Aty pranë qershisë që ndodhej në oborr. Rrrotulloi krahun në trungun e pemës. Djali i vajti pas.

— Sa bukur — pëshpëriti ajo dhe u kthyte nga djaloshi. Vështrimi i tij ishte i ngrohtë. Ajo iu afroa dhe i kapi duart. Ishin aq afër, sa ndjenin frymë-marrjen e shpejtë të njëri-tjetrit.

Ai ndjeu mbi faqe flokët e butë të vajzës, aromën e tyre kundërmuese si lulet e pranverës dhe...

— Mark, unë... unë të dua! — mezi mundi të fliste vajza dhe papritur u shkëput nga krahët e tij duke hyrë me rrëmbim në shtëpi. Djaloshi mbeti si i ngrirë nga kjo ndodhi kaq e papritur. Pra ajo e dashuronte. Të dy e ruanin në zemër ndjenjën e ëmbël, mundoheshin ta ndrydhnin, por nuk mundnin. I erdhi të thërriste nga gjëzimi: «Ajo më dashuron!» — pastaj kapi me të dyja duart trungun e qershisë, sikur të shtrëngonte në krahë trupin e brishtë të Luljetës...


Me këto kujtime të ëmbla, Luljetën e zuri gjumi dhe në gjumë pa një èndërr të çuditshme, sikur doli nga shtëpia e fshatit me valixhen në dorë dhe nisi të vraponte.

— Luljeta, Luljeta — u dëgjua zëri i Markut. Ajo qëndroi. Buzët e kuqe i dridheshin nga emociioni.

— Luljeta, ku po shkon?

— Mark — mezi mundi të fliste — unë... po iki... mama ja më ka fejuar me një burrë... që unë nuk e njoh...

— Dhe ti pranove, Luljeta? Po dashuria jonë? Edhe sot nuk gjen dot forca?



Ajo nuk u përgjegj. Fjalët nuk i dilnin dot nga goja. Ç'kishte kështu? Buzët i ishin shtrënguar si me darë.

Márku u zhduk. Ajo thirri me tërë fuqinë:

— Mark, Mark! Më prit, unë do të vij me ty, Mark!

Kodrat, luginat dhe malet ushtuan:

— Mark! Mark!

Luljeta u përpëlit në krevat dhe hapi sytë e trembur.

— Uh, çfarë èndrre! — foli e lehtësuar.

Jashtë kishte filluar të zbardhëllente. Në qìell ishin shuar dhe yjet e fundit. Nga rruga vinte zhurma që lëshonte fërkimi i fshesës me asfaltin. Pastriesit e rrugëve kishin filluar nga puna. Diku larg u dëgjua férshëllima e mprehtë e trenit dhe më afër një bori maqine. Qyteti i madh po zgjоhej.

## BIRI I HEROIT

Shiu vazhdonte të binte. Kapotat e ushtarëve kullonin ujë. Balta e kuqe u ngjitej pas këpucëve. Përpara printe komandanti i skuadrës. Nga buzët e lagura dhe të trasha i dilte një melodi e lehtë që sa vinte e ngrihej nga bashkimi i dhjetëra zërave, të tjerë. Kënga e fuqishme u përhap luginës së thellë:

*«...Mbi supe shi,  
Nën këmbë baltë...»*

Lugina mori jetë, u gjallërua. Shiu vazhdonte të binte ashtu si bien zakonisht shirat në dimër, të shtruara, të imta, dhe të ftohta. Dhe e ftohta atyre u kalonte mbi kokat e qethura në ato ditë dhjetorë. S'kishte veçse disa ditë që kishin veshur uniformë e ushtarit.

Kolona zbriti poshtë dhe qëndroi para bregut të lumit. Ujët e turbullt shkumëzonte duke sjellë me vete gurë, dru, baltë e gjithshka që gjente përparë. Kënga pushoi.

— Duhet kaluar lumi! — urdhëroi oficeri dhe sytë e tij të kaltër nën vetullat e trasha u drejtuan nga komandanti i skuadrës.

— Si urdhëron, shoku komendant! — u përgjegj ky i fundit, ndërsa oficeri thinojsh vazhdonte ta shikonte me një interes të veçantë.

«Ku e kam parë këtë fytyrë?» — mendoi me vete oficeri. «Ku i kam njohur këta sy, këtë zë? Diçka e parë, e dëgjuar, po vallë kush mund të jetë?»

Oficeri buzëqeshi, iu afrua komandantit të skuadrës dhe e pyeti:

- Si ju quajnë?
- Ushtar Skënder Sina.



«Sina?» — përsëriti me vete oficeri dhe u drodh. Ngriti kokën për ta parë edhe një herë ushtar e ri, por ai tashmë kishte hyrë në lumë. Me vete tërhiqte një litar të gjatë. Ujët e rrëmbyer përplasej në gjoksin e tij të gjerë ndërsa ai ecte drejt, derisa arriti matanë bregut dhe e lidhi litarin në një trung peme. Kolona u fut në lumë. Në krye ecte oficeri. Edhe ai, megjithëse jo i ri në moshë, përleshej me rrjedhën e lomit. Duke vështruar këtë pamje, Skënderi buzëqeshtë dhe nuk ia ndante vështrimin komandantit.

Befas u dëgjua një e thirrur:

— Shoku komendant, u rrëzua Selimi!

Të gjithë kthyen kokën. Selimi, që ishte i fundit në rresht, kishte hedhur mbi supe mitralozin. Këmbët i rrëshqitën poshtë gurëve të mprehtë dhe vala e rrëmbeu në çast. Ai u duk sipër valëve 10-15 metra larg shokëve duke u përleshur me ujët e rrëmbyer. Vala sa vinte dhe e shtynte poshtë e më poshtë, derisa e përplasi rrëzë një shkëmbi të madh. Katër ushtarë, që kishin dalë në breg, u shkëputën nga rreshti dhe u hodhën në ujët e ftohtë. Midis tyre ishte edhe Skënderi. Sytë kureshtarë e téré ankth të të tjerëve ishin drejtar nga valët e lomit. Komandanti dukej shumë i shqetësuar. Ishte gati të përleshej edhe ai me valët, mjaft të shpëtonte ushtar e tij. Në këtë kohë katër palë duar të fuqishme e kapën dhe e nxorën në breg trupin e shokut që ishte në rrezik të mbytej. Ushtar Selimi kishte humbur ndjenjat. Dukej se kishte pirë shumë ujë. Oficeri e rrëmbeu në krah dhe e ktheu me kokë poshtë. Nga goja e ushtarit u zbraz ujë. Pastaj me lëvizje të shpejta filloi t'i bënte frymëmarrjen artificiale. Selimi hapi sytë dhe foli:

— Mitralozi, mitralozi...

Por fjalët e tij u mbytën nga zëri i fuqishëm i Skënder Sinës që iu drejtua oficerit:

— Shoku komandant, më lejoni të shpëtoj teknikën luftarake!

Zëri i tij qe i vendosur dhe shprehja e syve nuk pranonte asnje kundërshtim. Oficeri buzëqeshi dhe e lejoi ta kryente detyrën.

Skënderi u hodh menjëherë në ujët e shkumëzuar. Valët e shtynin gjithnjë poshtë, por ai, i kapur pas shkëmbit, luftonte me to. U zhyt në ujë. Të gjithë qëndronin në ankth dhe prisnin nga çasti në çast të shihnin Skënderin. Trupi i tij zhytej gjithnjë e më thellë. Arriti fundin. Duart i prekën tokën. Valët e shtynin. Ai shtrëngohet, kërkonte me duar por nuk e gjente dot atë që deshi të shpëtonte. Veshtë filluan t'i dhimbnin. U ngjit lart e doli në breg. Shokët e rrethuan.

— Një litar! — u tha atyre me të shpejtë.

— Shoku komandant, të hidhem edhe unë?! — iu drejtua oficerit Selimi, që e kishte marrë veten — e di mirë vendin ku më shpëtoi mitralozi.

— Të hidhem edhe unë! — tha një ushtar tjetër.

— Unë!.. Unë!.. Unë!..

— Jo, shoku komandant, më përket mua ta nxjerr — u hodh me vrull Skënderi. Sytë e tij shprehnin vendosmëri.

Lidhi për mesi litarin dhe, pasi ua dha një anë shokëve që ta mbanin, u fut në lumë. Oficerit iu fiksua në mendje shprehja e vendosur e syve të tij dhe i kujtoi diçka... Ishin ditë gushti të 49-ës, atëherë kur monarkofashistët grekë kishin hyrë në tokën tonë.

Kudo krisma, erë barot, vapë. Dalipi nuk du-

kej asgjékundi. Të gjithë kujtonin se ishte vrarë, kur papritmas u dëgjua një gjëmim i fuqishëm. Mitralozi armik pushoi.

— Gjallë — thirrën të gjithë me një zë dhe në fytyrat e nxira nga dielli dhe nga tymi i barotit shkëlqeu gëzimi.

Papritur në qielin e kaltër u duk një raketë e kuqe. Ishte sinjali për sulm. Beteja u ndez e ash-për. Rrëzë një bregu pamë të shtrirë skuadërkomandantin tonë, Dalipin. Kraharorin e gjerë e lesh-tor ia kishin mbuluar gjaku e balta. Kishte luftuar ashtu i plagosur derisa ishin tërhequr edhe monarkot e fundit. U ula pranë kokës së tij dhe duke i lëmuar ballin e gjerë i fola: «Dalip, Dalip...» — por buzët e tija nuk u hapën. Vetëm shprehja e syve, sikur të ishte i gjallë, tregonte besim për fitore...

Po ky guxim, oficer Bardhylit iu paraqit sot me një zë kumbues. «Jo, shoku komendant, më përket mua ta nxjerr!»

«Po, tha me vete oficeri, ky është i biri i Dalipit, ai Skënderi i vogël.»

Vegimet iu shkëputën, vështrimi i tij u ngul përsëri mbi valët e lumit, ku biri i heroit luftonte me to.

Skënderi u shfaq mbi valë me mitralozin ndër duar. Nga gjokset e ushtarëve buçiti një «urra» e fortë. Oficeri u sul drejt tij, e pushtoi ndër krahë dhe, duke e përqafuar, i tha:

— Të lumtë, o bir heroi!...

Muzgu i mbrëmjes kishte zbritur poshtë në lu-ginë. Shiu vazhdonte të binte. Kolona mori përsëri rrugën duke kënduar:

«...Mbi supe shi,  
Nën këmbë baltë...»

## HISTORIA E BARESHËS

Xhibja e la tufën e dhenve nën hijen e rravitë madh dhe vrapoi poshtë burimit për të shuar etjen. Një përrua i vogël, që zbriste nga mali, lëshonte një gurgullimë të mbytur, duke rrëshqitur midis gurëve të lëmuar. Në të dyja anët e brigjeve kishin mbirë si kurorë degët e lajthive, duke i veshur me një gjelbërim të përhershëm. Aty ishte dhe burimi, një burim me ujë të ftohtë e të kulluar.

Ajo u përkul të pinte ujë. Ujët i ravijëzoi fytyrën si në pasqyrë. Një fytyrë e skuqur nga dielli, dy sy të kaltër, që e vështronin me vëmendje dhe një kaçurrel i artë flokësh, i dalë poshtë shamisë, e hijeshonin vajzën. Iu duk vetja e bukur dhe buzëqeshi. Ishte një buzëqeshje e pastër, e ciltër dhe e sinqertë. Pastaj mbështeti buzët. Fytyra iu shumëfishua nga disa rrathë uji. Ngriti kokën dhe pa përsëri në burim. Për çudi, tashmë aty nuk ishte vetëm një fytyrë, por ishin dy. Ishte një fytyrë e bukur, rrumbullake, me ca mustaqe të holla e të zeza, me një qeleshe të bardhë e me një tufë flokësh sipër ballit. Ajo u tremb. Ishte gati të thërriste. Xhindi ishte futur në burim. I mallëkuari kishte zënë ujët. «O zot, shpëtoje bareshën e gjorë!»

Xhibja nuk lëvizte dot nga vendi, sikur ta kishin shtrënguar aty me qindra darë.

Ai i buzëqëshi ëmbël. Xhindi ishte i bukur. Vërtet ka edhe xhind të bukur?!

Ujët përsëri u turbullua dhe ajo dëgjoi një zë njeriu:

— Mos u trembe, Xhibe?

Baresha ngriti kokën. Para saj qëndronte një djalë shtatlartë.

— Erdha të pi 'pak ujë. Jam Batua, Batua i Tafilajve, nuk më njeh?

Vajza përsëri nuk iu përgjegj. E ç'ti thoshte? Ishte hera e parë që bisedonte kaq afër me një djalë, me një burrë që s'ishte i fisit të saj. Gjithë trupi i dridhej nga turpi dhe nga një frikë e pakuptueshme. Edhe xhind i vërtetë të kishte qenë ky Batua i Tafilajve, nuk do ta kishte gjendur kaq ngushtë. Kur ishin të vegjël, edhe kishin lojtur, por tani...

— Sa qenke rritun, Xhibe!..

Përroi gurgullonte. Burimi rridhte ngadalë. Degët e lajthive tundeshin nga një puhizë e lehtë, që freskonte gjithë luginën. Nga rrapi i madh erdhi blegërima e një qengji. Ishte manari i Xhibes. Ai nuk e kishte nënën. Delja kishte ngordhur, prandaj baresha e mbante me vete dhe tregonte më tepër kujdes..

— Ti je edhe e bukur, Xhibe, ti...

Baresha u drodh, u skuq, iu mpinë gjymtyrët. «O zot! — gati thirri — ç'është kështu?» Përroi iu rrotullua, burimi, lajthitet, fytyra e Batos, gjithshka. As vetë s'e kupto si u ngrit dhe vrapi në pyll.

Dielli ishte gati në të perënduar sipër Malit të Dhoksit. Horizonti po merrte një ngjyrë të përgjaja-



kur. Hija e rrapit u zgjat shumë në tokë. Muzgu i mbrëmjes po zbriste vjedhurazi mbi fshat, në shtëpitë e shpërndara si gjethet e rrapit në vjeshtë.

Xhibja mori tufën e bagëtive dhe u nis drejt kullës. Manari e ndiqte prapa. Baresha nuk po e përkëdhelte më si ditët e tjera. Sytë e kaltër të vajzës ishin të menduar. Xhibes nuk i shqitej nga mendja Batua i Tafilajve, që i foli pa turp; po aq ëmbël.

«Mos u trembe, Xhibe?»

— ?!

«Sa qenke rritun, Xhibe!..»

— ?!

«Ti je edhe e bukur, Xhibe...»

Vajzës përsëri iu mpinë gjymtyrët. Zemra filloi t'i trokasë me forcë. Fytyra iu skuq si shegë e arri-rë. Nuk e njihte ndjenjën e moshës, nuk e kuptonte dashurinë. Dashuria ishte turpi më i madh nga të gjitha turpet e tjera. Batua i Tafilajve nuk duhej t'i dilte më përpara syve. Ai po i sillte shqetësimë vajzës, shqetësimë të hidhura e megjithatë nuk e hiqte dot nga mendja, sepse kishte pak ëmbëlsi në këto ndjenja të trazuara.

Dielli perëndoi. Baresha futi bagëtinë në vathë dhe filloi të milte delet, mori qumshtin dhe pastaj hyri në motfag<sup>1)</sup>.

Në shtëpi ishin vetëm të dy, vëlla e motër. Ish-te e vogël, kur i vdiq i ati. Vëllai i kishte thënë se e kishte vrarë hasmi. Edhe nëna i kishte vdekur gjatë lindjes, duke e lënë kërthi.

Zjarri bubullonte në oxhak. Edhe pse verë, malësorët e bjeshkëve natën ndezin zjarre nëpër

---

1) Motfag malësorët quajnë një dhomë zjarri me oxhak, ku rrinë e gatuajnë,

oxhaqe. Netët janë të freskëta në male. Vatra s'kishte llambë, as bishtuk. Ajo ndriçohej vetëm nga flaka e zjarrit. Në mur, mbi një gozhdë, ishte varur pushka. Hijet ravijëzoheshin mbi trarë, stérzmadhoheshin, zhdukeshin e krijheshin përsëri, si në një valle xhindesh. Xhind! Dhe Xhibes iu kujtua përsëri Batua i Tafilajve, iu kujtua... Sytë i vajtën te pushka varur në një gozhdë. Pushka qëndronte grykëposhtë. Vëllai nuk e kishte marrë gjakun. Hasmi ishte i gjallë.

Hodhi përsëri vështrimin nga i vëllai, që rrinte i menduar, i zymtë, i mbështetur në mur, duke tymosur duhan. Era luante me kanatën e dritares një melodi trishtimi.

Vëllai hoqi cigaren nga goja. Motra e vështroi në sy. Ai nxori tymin, vajza priti të fliste:

- Tani u rrite, Xhibe!
- ?!
- U bane vajzë e madhe.
- ?!

— Erdhi një shkes dhe të kërkoi në fisin e Cunajve për djalin e Hysenit. Cunajt janë fis i pasur.

Xhibja uli kokën dhe shikoi urën e zjarrit, që po e përpinte flaka.

- Te Cunajt do të jesh rehat. Qoftë për hair!

Baresha nuk u përgjegj. E ç't'i thoshte? Se djali i Cunajve ishte 40 vjeç? Se djali i Cunajve ishte sakat nga këmba?! Ajo vetëm uli kokën. Kaçurrelat ia mbulonin ballin. Zjarri ishte gati në të shuar. Vatrën e mbulonte errësira.

Mbështeti kokën përdhe dhe kështu e zuri gjumi, një gjumë me ëndrra të shqetësuara, si vetë ndodhia e ditës. Iu bë sikur u martua me Baton e Tafilajve. Ai erdhi me një kalë të madh të bardhë, si qe-

leshja që mbante në kokë. Xhibja zbriste monopatit me delet.

«A po vjen me mue, Xhibe?»

«Mos, Bato, mos» — gati klithi malësorja. — «Ti nuk duhet të më marrësh mue, se vëllanë tim e kërcënë vdekja, se vëllanë tim do ta vrassë Hyseni i Cunajve. Ai e ka dhanë fjalën. Ne nuk mund të martohemi dot bashkë, ne...» — dhë vajza u hodh nga vithet e kalit, duke u rrrokullisur nga një lartësi e madhe sipër shkëmbit....

Xhibja hapi sytë e trembur dhe pa se ndodhej e shtrirë pranë oxhakut në motfag. Yjet e fundit ishin shuar në qiell dhe muzgu i mëngjezit kishte veshur lindjen me një ngjyrë të përflakur. Po agonte.

U ngrit dhe shkoi te tufa e dhenve.

## II

Krushqit erdhën me kuaj, i binin lodrës e qisnin pushkë. Luginat përcollën oshtimën e thatë të kris-mave. Malësorët shikonin krushqit nga frengjité e kullave.

Ata u ulën këmbëkryq në postet e odës së burrave, varën pushkët në gozhdë dhe shkëmbyen cigare.

Xhibja, e veshur nuse, rrinte në odën e grave. Nga sytë e trishtuar poshtë duvakut rridhnin pika lötësh. E si do të martohet me Hysenin e Cunajve, me atë burrë dyzetvjeçar?

Baresha ende nuk i kishte mbushur të tetëmbë-dhjetat. Shtrëngoi grushtat aq, sa ndjeu dhembje në

mollézat e duarve. Ç'të bënte? A mund tē kundërshtonte? Batua i Tafilajve i dilte gjithmonë përpara duke buzëqeshur.

Gratë e kishin rrethuar, duke i prekur trupin, duart, duvakun e qëndisur me fije ari.

— Të trashëgohesh! Ke hy në nji fis tē madh, tē pasun.

Vajzës i vinin në kokë lloj-lloj mendimesh.

— Më lini pak vetëm — u tha ajo grave më në fund. Ato panë njera-tjetërën tē çuditura, pastaj dolën nga oda.

Xhibja hoqi duvakun... rrëmbeu gérshérën e dhenve dhe, me shpejtësi preu flokët, veshi pantallonat e tē vëllait, vuri një qeleshe sipër flokëve të qethur, pastaj hyri në dhomën e krushqve.

— Mirë se keni ardhë, burra, në konakun tonë!

— foli me guxim baresha.

Krushqit shtangën tē habitur. Kryeplaku i Cunajve vuri dorën mbi patllaken e brezit, që e mban te gjithmonë me vete. Mustaqet i lëvizën me ner-vozizëm. Ç'ishte kështu, nusja po e koriste? Një gjë e këtillë nuk kishte ndodhur kurrë në këto bjeshkë.

Xhibja hodhi vështrimin nga i vëllai, që kishte marrë një ngjyrë limoni në fytyrë. Cigarja e ndezur i ra nga duart mbi postiqen e dashit. Motra e tij ishte çmendur. Xiben e tij tē mirë e kishin push-tuar tē mallékuarit.

Krushku i madh u ngrit rrëmbimthi dhe, pa i hedhur sytë nga vajza, iu drejtua vëllait tē bareshës:

— Nuk ta kishim borxh këtë, o Bakiu i Elezajve!

Krushqit e tjerë morën pushkët nga gozhdët. Sherri mund tē plaste nga çasti në çast. Xhibja u hodh si sorkadhe në mes tē burrave.

— Ndaluni, burra, pse e merrni kaq rrëmbyer? Unë nuk e shaj fisin e Cunajve, as djalin, por nuk due të martohem. Due ta kaloj jetën pranë vëllait të vetëm, pa dalë nga shtëpia.

Ata përsëri shtrënguan pushkët, sikur donin ta qëllonin vajzën, të qëllonin turpin që i vuri fisit të tyre.

— I mallëkuemi paska hy në shpirtin e saj — tha dikush nga pleqtë.

— Dëgjo, o Baki i Elezajve, ne nuk flasim me gratë. Në qoftë se jot motër do të martohet me dikë tjetër, me fisin e Cunajve je në gjak!

Përplasi pushkën përtokë dhe doli jashtë si furtunë. Prapa e ndoqën krushqit e tjerë.

U hipën kuajve dhe u nisën nëpër kullat e tyre sikur të përcillnin një të vdekur.

Dhe nuk u martua Xhibja me Hysenin e Cunajve, me burrin e vjetër, që ia kishte gjetur lajmësi. Ajo e kundërshtoi këtë martesë në mënyrë të tertiorthë për atë kohë, por e mbylli veten brenda katër mureve të shtëpisë, nën qeleshen e bardhë dhe me pantallonat e të vëllait, duke mbytur me helm èndrrat e rinisë, èndrrat e dashurisë, kujtimin e Batos së Ta filajve dhe gjithë jetën e saj.

Kanuni nuk e lejonte të martohej me një burrë tjetër.

Pas disa vjetësh ajo përsëri doli nga shtëpia, mori tufën e dhene dhe e nxori në bjeshkë. Tani nga burimi i ftohtë nuk e shikonin më sytë e kaltër, flokët ngjyrë ari që i dilnin poshtë shamisë, por një ftyrë e vuajtur, me shenja dhembjeje, sy të futur në gropëza dhe balli i rrudhur me qeleshen në kokë.

## D A S M A

Nga dhoma tjetër vijnë tingujt e fizarmonikës dhe ritmi i dajres. Shoqet më kanë rrrethuar dhe po më veshin fustanin e bardhë. Nuk e di çfarë ndjejnë në këto momente vajzat, lumturi, apo keqardhje, por unë do të dëshiroja që kështu e veshur me fustanin e bardhë, e bërë nuse, t'i hidhesha në krahë Ermalit, ta përqafqoja fort, ta puthja dhe t'i thosha:

«Tani u bëra nusja jote. A të pëlqej kështu? Sa kohë kam që e ëndërroj veten nuse? Katër vjet, që jam njohur dhe dashuruar me Malin. Sa kohë e gjata më duket! Dashuria jonë ka kaluar nëpër një labirint të tërë peripecish, por ja më në fund ajo triumfoi. Unë sot po bëhem nuse. Nesër do të jem e Ermalit! Ç'lumturi! Bjerini më fort dajres, le të ushtojë kënga, unë sot po bëhem nuse!

Ja dhe vellua. Vera po ma vendos mbi flokë. Kujdes, Vera, mos m'i prish flokët! E kam shoqe të ngushtë. Sa kujtime janë të lidhura me të. E, Vera, si thua, të kujtohet?» — Unë hedh sytë mbi shoqën dhe të dyja buzëqeshim.

Tani çdo gjë është gati. Të gjithë vijnë të më shikojnë, mama, babai, Mira, ja dhe dajua. Ai mundohet të tregohet i qeshur, por fytyra e rrudhosur dhe sytë e bardhë e tradhëtojnë. Më duket sikur e

mundon diçka. Nga çasti në çast pres të bjerë zilja e telefonit dhe të dëgjoj zérin e Ermalit. Ermali im është me shërbim në B... Po pse s'ka ardhur? Mbrëmë më telefonoi se do të nisej për sot. Kishte marrë lejë dhe kishte rregulluar gjithshka. Po pse s'ka ardhur? Kjo më shqetëson. Po edhe prindërit duken sikur janë të shqetësuar, dhe më hedhin vështrime të dyshimita. Dajua pi duhan me llullë i menduar e i zymtë. Shtëllungat e zeza të tymit ngrihen me përtesë lart, ashtu si mendimet e tij... Ai s'e do Ermalin. Ai do të më ndajë nga njeriu më i shtrenjtë, nga burri im. Sa mendime më vijnë në kokë. Shoqet këndojnë duke i rënë dajres.

«*Me të bardha, me të bardha veshur-o...*»

Kërcitjet e dajres më ngjajnë si ritme të hekurta.

Kërkoj me sy Verën dhe i bëj me shenjë nga telefoni. Ajo formon me kujdes numrin e shtëpisë së Ermalit.

— Alo, familja Qendro? — zemra më duket sikur më pushon për një çast. Asgjë s'ndjej. — Gëzuar, të trashëgohen, Vera jam... Nuk ka ardhur? — Vera mbyll receptorin. Çdo gjë më duket si e pabesueshme. Si është e mundur të mos vijë? Sonte është e shtunë. Nesër në orën dhjetë ai do të vijë të më marrë. Çfarë do t'i ketë ndodhur?

Njerëzit hyjnë e dalin në dhomë. Dëgjohen të qeshura, urime. Unë rri më këmbë me fustanin e bardhë dhe mendjen e kam tek Ermali. Tani ora është tetë e darkës.

Epo hajde, të trashëgohen, o i zoti i shtëpisë! — dhe dajua ngre gotën e rakisë me djallëzi.

— Të trashëgohen, të trashëgohen! — dëgjohen dhe zëra të tjerë. Babai ngre gotën dhe më vështron sikur më thotë: «Nuk ka ardhur ende, diçka do t'i ketë ngjarë. Po do të vijë, do të vijë, mos u merakos». Unë vetëm hesht. Vera më jep kurajo:

— Do të vijë, mos u mërzit. Ndoshta i ka dalë ndonjë punë. Këta ushtarakët kështu e kanë. Sikur **nuk** e njeh babin tim ti. **Edhe ai vjen në shtëpi për** Vitin e ri vetëm kur shkon ora dymbëdhjetë pa pesë — dhe ma rregullon fustanin duke më ulur në karrige.

**Edhe** mama ja dukej e shqetësuar. Herë pas here më afrohet dhe më thotë:

— E, moj vajzë, dhe kjo na u desh tani.

Këto fjalë më trondisin. Çudi, çdo gjë sot më bën përshtypje. Sytë gati më mbushen me lot. «Mali, pse kjo vonesë, nuk të kuptoj...»

...Është pothuaj në të aguar. Atmosfera e das-mës është shuar krejtësisht dhe nuk ndjehet asgjë. Gjithë shtëpinë duket sikur e ka mbuluar një perde e hollë trishtimi. Nga kuzhina vijnë copa bisedash.

## II

Ne atëhere ishim të rinj, fare të rinj, unë sapo kisha mbaruar maturën, ndërsa Ermali si kishte kryer ushtrinë e kishin futur në Shkollën ushtarake. U njohëm në hekurudhë. U miqësuam dhe u dashruam. **Dashuria për të rintjtë është, dhe ne nuk kishim frikë** nga kjo. Një ditë shkuam në Lushnjë. Shëtitëm bashkë në qytet, hëngrëm drekë bashkë dhe

unë mendoja që gjithmonë kështu të ishim, të dy për jetë, por asnjëri nuk i thoshte diçka tjetrit. Pastaj pritëm tek ura për të gjetur maqinë dhe takuam snoferin e autobotit që na sillte ujë.

Hipëm të dy në kabinën e maqinës. Më kujtohet çdo hollësi e saj. Një flamur ishte vendosur në një qoshe dhe pranë tij fotografia e familjes së Refikut. Unë vendosa duart mbi timon. Ishim në kabinë, të dy vetëm. Nga afër ndjenim të rrahurat e shpejta të zemrave. Mali u përkul të shihte fotografinë. Flokët e mi i prekën fytyrën. U skuqa e tëra. Ai më kapi dorën. As vetë s'e kuptova se si ndjeva mbi faqe buzët e tij të ngrohta. Ai më puthi. Unë vetëm i shtrëngova dorën dhe nuk fola asnjë fjalë, por me zemër i premtuam njëri-tjetrit dashurinë dhe besnikërinë.

...Kur erdhëm në Tiranë, mua më kishte dalë e drejta e studimit, për biokimi dhe ndërsa Mali vazhdonte studimet në Shkollën ushtarake.

Unë shkoja dhe e takoja gjithmonë në Shkollën ushtarake. Se si më dukej Mali me uniformën e blerëtë të kursantit, me rripin e mesit shtrënguar dhe me yllin e kuq mbi ballë. Më dukej më serioz, më i matur në fjalë. Dhe unë mendoja e gëzuar: «Ky është Mali im».

Vazhdonim kështu dashurinë tonë. Unë e doja me gjithë forcën e zemrës sime. Doja tek ai shpirtin e tij, njeriun.

Por kjo dashuri u trondit, kur një ditë në shtëpinë tonë erdhi dajua. Unë isha në dhomën time dhe po studjoja. Dajua bisedoi gjatë me prindërit e mi. Pastaj u hap dera dhe në dhomë hyri mamaja që duke më puthur më tha:

— Tani u rrite, Leta, (kështu më thërret edhe

Mali) u bëre vajzë e madhe. Dajua të ka gjetur një burrë, inxhinier.

Kur më tha këto fjalë, u zverdha krejt dhe dispenza e kimisë më ra nga dora; pastaj më hipi një zemërim dhe s'e përbajta veten.

— Khanëm, s'kam të drejtë që as shokun tim të jetës ta zgjedh vetë...

— Jo, moj vajzë, ç'thua kështu? Ti do ta shikosh vetë, ai do të vijë këtu, do të njiheni, apo s'është edhe me punë të mirë, këtu në Tiranë.

— Mama, të lutem, mos më folë kështu! Të më falni, që s'ju kam thënë më përpara por, mëqë u hap kjo çështje, unë s'kam ç'të fsheh më. Dua një djalë...

Dashuria më jepte krahë e guxim. Unë s'kisha frikë nga e vërteta.

— Ç'thua, moj e zezë, paske filluar edhe ti nga dashuriçkat?

Më mërzitën në kulm fjalët e saj.

— Unë e dua atë!

Jashtë kishte rënë errësira. Dritat e neonit ishin ndezur në rrugë dhe herë pas here vinte në dhomë zhurma e autobusit të unazës.

Në dhomë hynë babai dhe dajua me çibukun e tij të zi, që s'e hiqte asnjëherë nga goja.

— Pse bërtisni? — pyeti babai.

— Si të mos bërtas, na ka filluar nga dashuriçkat çupa dhe ne mundohemi kot.

Babai, dajua, mamaja më flisnin, por unë asgjë s'dëgjoja, asgjë s'ndjeja, mendja më rrinte tek Er-mali dhe kudo më shoqëronte fytyra e tij.

— Nuk dua të më fejoni me një që s'e njoh. Habisitem, baba, se si pajtohesh edhe ti me të tilla mendime!

Unë flisja, ata heshtnin.

— Sigurisht, burrë me zor ne nuk do të të jepim, ne s'jemi fanatikë, por gjithmonë duam të mirën tënde, më kupton?

— Jo, baba, të mirën time unë e kam gjetur vetë.

— Kush është ai që do ti? Ne nuk e njohim.

— Ermal Qendro — thashë e vendosur.

— Ku punon? — më pyeti dajua.

— Është në Shkollën e bashkuar të oficerëve — iu përgjegja pa e parë në sy.

— Oficer dashke ta marrësh burrin? Mos do që të rrish gjithë jetën me plaçka kurrizit, ikë këtu e ikë atje? — më pyeti dajua.

— Unë nuk dua pozitën, as postin, por njeriun. Vendi ynë është kudo.

Dispensa qëndronte ende e rrëzuar përtokë. U ulë dhe e ngrita. Nga mesi i faqeve doli fotografia e Malit. Ishte fotografi e bukur. Më pëlqente shumë. Kishte dalë veshur civil, me një xhaketë me kuarde, këmishë të bardhë dhe vetullat e harkuara e të zeza i rrethonin sytë e ëmbël ngjyrë gështenjë. Ma dhuroi kur ishim në aksion.

Mamaja ma rrëmbeu nga duart.

— Ky qenka bandilli yt? Po ky është fëmijë! Vajzë, mblidh mendtë; nuk të lemë të bësh sipas qej-fit! — dhe u bë gati ta griste fotografinë.

— Mos! — dhe unë ia mora nga duart ashtu si do të hidhësha për ta shpëtuar Malin nga çdo rrezik që mund ta kërcënonte.

— Këtë e dua dhe do ta dua gjithmonë, nuk mund të më ndani prej tij!

— E do, ë?! — tha dajua me të tallur.

Që nga ajo ditë dajua vinte gjithmonë në shtëpi-në tonë dhe fliste vetëm me babanë. Me mua asnjë nuk fliste, as Mira, motra e vogël, që më donte aq

shumë. Asnjë nuk hynte në dhomën time. Edhe Vëren e ndaluan. Për ta kisha bërë një turp, turp pse doja atë që më thoshte zemra. Vuaja tmerrësish nga kjo vetmi. Vetëm babai hynte herë pas here në dhomë dhe më fliste pér jetën, pér të ardhmen që më priste, më bënte edhe aluzion pér burrin që donte të më jepte dajua, por unë e kuptoja se ai ishte i shtyrrë nga dajua dhe se vetë ishte i lëkundur.

Një ditë i fola babait me zemër të hapur:

— Baba, a jam bija jote?

— Po, Violeta, pse ma thua këtë?

— A të kam turpëruar ndonjëherë?

— Jo, bijë... por ja... tani në fund...

— Jo, baba, nuk është turp të dashurosh. Unë dashurova një herë. Do t'i qëndroj besnike, baba, dhe ky nuk është turp.

Im atë më kapi duart:

— Mirë, vajzë, mirë, unë nuk kam kundërshtim, por ki kujdes,jeta është e madhe. Ndoshata ai s'të bën të lumtur.

— Jo, baba, nuk mendon drejt.

Akulli po fillonte të thyhej.

Të gjitha këto ia tregova Malit.

— Unë që nesër do të vij në shtëpinë tënde dhe të bisedoj me prindërit e tu. Do t'u kërkoj të fejohemi. Dua dhe një vit që të mbaroj shkollën pastaj, kur ta mbarosh dhe ti fakultetin, do të krijojmë familjen tonë. Të kujtohet çfarë ëndërronim kur ishim në Lushnjë?

Mali erdhi të nesërmen në shtëpi. Ishte tetor atëhere. Gjethet e zverdhura të pemëve binin parreshetur në tokë.

Dajua më rrinte gjithmonë ftohtë, mospërfillës dhe tërë inat.

### III

Ja, erdhi dhe e diela. Njerëzit filluan të ngrihen nga gjumi. Njerëz të tjerë vijnë për të uruar. Unë përsëri vesh fustanin e bardhë. Shoqet më kanë rrethuar dhe po këndojojnë. Përsëri dëgjohen ritmet e dajres dhe të fizarmonikës, megjithatë dasma nuk e ka ngjyrën e saj të djeshme. Kudo janë hapur fjalët:

«Dhëndrri nuk ka ardhur ende nga B...» Fjalët shkojnë gojë më gojë. Njerëzit pëshpërisin me njërit-tjetrin. Kudo duken fytyra të hutuara, që më shkojnë me shqetësim. Jam shumë e tronditur. Nuk e kuptoj vonesën e Malit. Atij patjetër do t'i ketë ndodhur diçka. Mamaja nuk më lë t'i afrohem telefonit. Dua të marr qytetin B. dhe të pyes repartin, por vështrimet e dajos dhe, të mamasë më gozhdojnë.

«Vetë e kërkove, prite tani!»

Babai kalon sa në një dhomë në tjetrën. Duket i hutuar. Krushqit nuk po vijnë ende. Kalamajtë e shkallës dalin për të parë veturën dhe kthehen pa shpresë. Përsëri fjalët kalojnë gojë më gojë:

«U vonuan krushqit. Sikur thanë që do ta marrin nusen në orën dhjetë?!»


Shikoi orën. Ajo është 10 e pesë minuta, pra Mali nuk erdhi as në orën e caktuar. Kjo përsëri më shqetëson, jo se Mali nuk më do, por kam frikë mos i ka ndodhur ndonjë gjë. Tani nuk ndjehen as ritmi i dajres dhe as tingujt e fizarmonikës.

Edhe shoqet pushuan së kënduari.

Vetëm Vera më qëndron afër dhe më qetëson:

— Mos u shqetëso. Mali ka për të ardhur, po ku

ta dish, ushtarakë janë ata. U ka dalë ndonjë punë  
dhe ...



— Po, Vera, kështu është. Unë e njoh mirë Malin. Kam katër vjet — dhe hodha sytë në dhomë. Dajua se çfarë po i flet nënës. Babai për çudi m'u duk i qetë.

Atmosfera është e rëndë. Nga të katër anët më ndjekin sy të çuditshëm. Tani njerëzit hyjnë e dalin dhe nuk më urojnë e as më shtrëngojnë dorën. Kjo më mbush me inat dhe më vjen të bërtas:

«Bjerini dajres! Fizarmoniqist, këtu ka dasmë!»

Ora ka shkuar dhjetë e gjysmë. Kurse unë po që-ndroj ende më këmbë, duke pritur, kur befas nga fundi i shkallëve vijnë disa zëra fëmijësh që ngjiten deri në dhomë:

— Erdhën, erdhën krushqit!

— Erdhën, erdhën! — bërtasin të gjithë.

Ndjej të çlirohem nga diçka. Vera më shtrëngon dorën me dashuri. Njerëzit dalin në shkallë për të pritur krushqit. S'më durohet ta shoh Malin dhëndërr. Nuk e sjell dot ndër mend civil. Ai gjithmonë më del përpara veshur me uniformën ushtarake, me rripin shtrënguar mesit dhe yllin e kuq.

— Gëzuar, gëzuar, të trashëgohen dhe jetë të lumtur! — vijnë zëra.

Zemra më rreh fort, gjunjët më duket se s'do të më mbajnë. «Do të ketë ardhur Mali?!

Në derë duken vjehrri, vjehrra, Oli, motra e Malit dhe njerëz të tjerë. Pas tyre hyn Ermali, i qeshur, po i lodhur.

— Sikur e kishim fjalën për në orën 10, o krushk — dëgjoj të thotë dajua i zemëruar dhe me vetulla të ngrysura.

— Ashtu vërtet, po të na falni! Pritëm të vinte Ermali, prandaj u vonuam — u përgjegj vjehrri i hutuar nga fjalët e dajos.

— U, ç'është ajo, urdhëroni, urdhëroni, — flet babai buzëgaz — uluni e të na trashëgohen! Po këto janë gjëra të vogla. Ushtarakët kështu e kanë, mbajnë mbi supe detyra të rëndësishme dhe harrojnë, ose më mirë, lenë pasdore të tjerat.

Krushqit filluan të lëvizin nga stepja që shkaktoi ndërhyrja e papritur e dajos. Zunë vendet dhe vetëm tani e mblodha veten dhe pashë se pranë meje që ulur Ermali.

— Leta, më fal, por diçka më ndodhi. E di që do të më japësh të drejtë, kur ta mësosh arësyen.

— S'ka gjë, Ermal, s'ka gjë, unë të kuptoj ty.

## *PASQYRA E LËNDËS*

Demo Çobani .....	3
Vajzat dhe ushtari .....	11
Kollovari .....	15
Buzë detit .....	21
Luljeta .....	30
Biri i heroit .....	39
Historia e bareshës .....	44
Dasma .....	52